



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E FINANCAVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
NJËSIA QENDRORE E HARMONIZIMIT PËR
MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN**

Nr 2628/3

UDHËZIM

dt 21.5.14

Nr 5/1 datë 21.5 2014

PËR

**NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.5, DATË 27.02.2014 “PËR SHLYERJEN E
DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 50, datë 5.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, pika 3”, dhe në vijim të Vendimit Nr.5, datë 18.04.2014 të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura, Ministri i Financave:

UDHËZON

1. Në pikën 3 të Udhëzimit Nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pas fjalisë së parë shtohet fjalia “Këto pagesa do të kryhen vetëm pas miratimit nga Nëpunësi i Parë Autorizues në Ministrinë e Financave.” Miratimi jepet me shkrim ose në rrugë elektronike tek dega e thesarit ku kryhet pagesa.
2. Në pikën 16, 28 dhe 30 të udhëzimit Nr.5, datë 27.02.2014, krahas fjalës “tatimore” shtohet edhe “doganore”.
3. Në pikën 30 të udhëzimit Nr.5, datë 27.02.2014 ndryshon gërma (b) dhe shtohet gërma (c) si vijon:
 - b. Transfertë në një llogari bankare escrow kundrejt konsensusit për shlyerjen e detyrimeve tatimore/doganore, të shprehur me një marrëveshje/dokument vërtetues midis Subjektit përfitues dhe Bankës së nivelit të dytë ku ka llogarinë subjekti, e cila i dorëzohet institucionit pages. Kjo marrëveshje/dokument të jetë pjesë e dosjes që dorëzohet nga institucioni në thesar për urdhërimin e pagesës. Ministria e Financave, bazuar në marrëveshjen kuadër me Bankat e nivelit të dytë, i kërkon këtyre të fundit konfirmimin pranë degëve të thesarit respektive, të hapjes së çdo llogarie bankare escrow për subjektet përfituese me referencat përkatëse ku do të kryhet transfertat bankare.

- c. Pas paraqitjes në thesar të një vërtetimi nga organet Tatimore/Doganore që subjekti në fjalë nuk ka më detyrime tatimore/doganore ndaj administratës qëndrore.
4. Pika 20 e udhëzimit ndryshon si vijon: “Brënda 10 ditëve pune nga data e alokimit të fondeve, nëpunësit autorizues urdhërojnë në thesar kryerjen e pagesave për detyrimet e prapambetura, duke respektuar radhën kohore të lindjes së detyrimit sipas listës së miratuar. Në rastet e mosurdhërimit në kohë dhe të paargumentuar të pagesave si më lart, përgjegjësi i degës së thesarit bllokoi pagesat e njësive respektive deri në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.
5. Pas pikës 30 shtohet pika 30/1 me këtë përmbajtje:
- a. Në rast të paraqitjes së urdhrave të sekuestros nga shërbimi përmbarimor, në zbatim të neneve 581, 582, dhe 583 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ministria e Financave nëpërmjet Njesisë së Posaçme të Administrimit dhe Monitorimit të Detyrimeve të Prapambetura (NjPAMDP) kryen veprimet e mëposhtme.
- (i) Bën verifikimin për ekzistencën e detyrimit të prapambetur që Njësia e Qeverisjes së Përgjithshme, sipas kuptimit të dhënë në pikën 1 të Udhëzimit Nr. 5, datë 27.02.2014, mund të ketë ndaj subjektit që rezulton debitor në urdhrin për vendosjen e sekuestros të dërguar nga shërbimi përmbarimor.
- (ii) Në rast të ekzistencës së detyrimit NjPAMDP dërgon pranë Degës përkatëse të Thesarit urdhrin e sekuestros të dërguar nga shërbimi përmbarimor, duke vënë në dijeni edhe shërbimin përmbarimor.
- b. Dega përkatëse e Thesarit, në momentin, që merr urdhrin e pagesës nga Njësia e Qeverisjes së Përgjithshme, njofton menjëherë Shërbimin Përmbarimor përkatës për llogarinë bankare në të cilën do të kryhet pagesa e detyrimit të prapambetur.
- c. Dega përkatëse e Thesarit kryen transferimin e vlerës së detyrimit të prapambetur në llogarinë bankare të subjektit/individit vetëm pasi të kenë kaluar pesë ditë pune nga momenti i njoftimit të shërbimit përmbarimor për llogarinë bankare në të cilën do të kryejë transferimin e pagesës.
- d. Për çdo procedurë të kryer sipas këtij paragrafi Dega e Thesarit mban një dosje të plotë ku përfshihen urdhrat e përmbaruesve gjyqësorë për vendosjen e sekuestros dhe korrespondenca me përmbaruesit gjyqësor.
6. Shtojca 1 e Udhëzimit Nr.5, datë 27.02.2014 ndryshon sipas formateve bashkëlidhur.
7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në gazetën zyrtare.

SHKËLQIM CANI

MINISTËR

